

BEGZAT RRAHMANI

RREZE MIRËSIE

BEGZAT RRAHMANI

R R E Z E MIR Ë S I

-POEZI FETARE-

Feniks- Kërçovë, 2003

Redaktor: Hysen Kaleshi

Recensentë: Safet Q. Purellku
Qufli Osmani

Lektore: prof. Gëzime Baftiri

Radhitja kompjuterike:
Feniks- Kërçovë

Për ballinën u kujdes:
Arton Ahmadi

Botoi dhe shtypi:
Feniks-Kërçovë

Kërçovë,2003

BOTIMIN E FINANCOI:BASHKËSIA ISLAME
REGENSDORF ALTHARDSTRASSE-10
8105 REGENSDORF
ZURICH-ZVICËR

PËR FAMILJEN TIME:
BASHKËSHORTES, VEXHIJE
VAJZAVE: GËZIME, TEUTA DHE YLLZËS ME PËRKUSHTIM

FJALA E RECENSENTIT:

Kësaj radhe poeti dhe shkrimtari Begzat Rrahmani përpara lexuesve paraqitet me një përmbledhje poezish me përmbajtje fetare, e cila mbart një shprehje të fuqishme artistike-shpirtërore Islame.

Ky është një punim me përkushtim dhe pasion, por njëkohësisht edhe sintezë dhe art në penë origjinale i këtij autori.

Në këto poezi autori i prezanton vargje me vlera nga Kur' ani famë lartë si kryevepër dhe ligj shumë shekullor i botës Islame.

Vepra është shkruar me një mjeshtri të artit poetik, në një nivel sa komunikues aq edhe intim, dhe me këtë përmbledhje poezish autori kësaj radhe rrugëton në botën e madhe të letërsisë Islame.

Në përmbledhjen që prezantojmë " Rreze Mirësie", hasim në poezi me tituj si: Kur' ani, Leximi, Besimtari, Koha, Përjetimet, Lapsi, Profetët, Drita, Dituria dhe shumë tituj të tjerë. Do të citoj ca vargje nga poezia "Koha" të kësaj përmbledhje:

Koha s' të pret
Pasi s' ka mëshirë
I regjistron veprat
Të keqe dhe të mirë.

Kjo dhe shumë poezi të tjera janë si lulet e pranverës me aromë dhe ngjyra të tyre pranverore, që të qetësojnë shumë shpirtra të trazuar.

Me leximin e këtyre poezive lexuesit zbulojnë një botë krijuese me mendime fetaro-kombëtar, ku mbizotëron dashuria për Zotin, Kur' anin, Dijeninë dhe Atdheun.

Autori me pak fjalë arrin të hedh shumë dritë në tërë atmosferën e një periudhe shumë shekullore, dhe si vazhdues i zinxhirit të dijes poetiko-Islame, do të hapi rrugën edhe shumë punimeve të tjera të kësaj natyre, që prej kur janë shumë të rralla në tërë hapësirën Ballkanike dhe më gjerë.

Janar, 2003 Safet Q. Purellku

KUR’ ANI

Si oqean i pa fund
Është Kur’ ani i madhëruar
Për të njohur botën
Atë duhej studiuar.

Prandaj ty o njeri
Zoti të fali mendjen
Ta hulumtosh atë
Që me sy e vëre.

Të shkosh edhe më lart
Në trupat qiellor
Atë që ta kap truri e syri
Zoti ta la në dorë.

Përherë është Kur’ ani
-BURIM I DITURISË-
Që ia fali Zoti
Si privilegj njerëzisë.

PËRJETIMET

-Muhamedit a.s-

Shpjegonte Kur’ ani
Pasi adhuronte Perëndinë
Engjëlli i nderuar Xhibril
Ia sillte me radhë Diturinë.

Në vetmi PËRJETONTE
Ato fjalë të bukura
Në zemër, tru e shpirt
Merrte krahë si flutura.

Urrente idhujt dhe idhujtarët
Që harxhonin kohë e materiale plot
A s’ deshën të besojnë
Krijuesin e motrave – ZOT.

Si jetim Muhamedi a.s
I besonte veç një PERËNDIJE
Që tash KUR’ ANI famë lartë
I shton emër dhe hije.

PROFETËT

Edhe të dërguarit e ZOTIT
Kanë qenë njerëz si ne
I kanë lindur prindër
Por është kujdesur një re.

Kanë komunikuar me engjëjt
Për të mirën e njerëzisë
Pasi s' kanë bërë gabime
Në urdhrat e Perëndisë.

S' mbaheshin kokë lartë
Si duronin as adhurimet
Përherë në mesin e njerëzve
Përjetonin gëzimet.

Profetit MUHAMED
KUR' ANI iu shpall
Dhuratë e Perëndisë
MREKULLI e rrallë.

ENGJËJT

Prej kur i ka krijuar Zoti
Engjëjt kurrë s’ kanë bërë gabim
Kryejnë urdhrat e dhëna
Me devotshmëri dhe pa devijim.

Me besën që kanë
Dhe si fëmijë të bukur
Me krahë mbi shpinë
Fluturojnë si flutur.

Janë të përjetshëm
Si edhe vet KRIJUESI
S’ ka ç’ u bënë djalli
As njeri mashtruesi.

Për Zotin dhe Engjëjt
Lexoni pa ndal
Librin e shenjtë KUR’ ANIN
Që juve o njerëz u është fal.

BESIMTARI

Kurrë s’ vdes besimtari
Që beson në një ZOT
Ai vetëm kalon prej njërës
Në një tjetër botë.

E ka kuptuar jetën
Si në ëndërr e gjumë
Të bëjë vepra të mira
E të mos përdori dhunë.

Kryen obligimet e jetës
Viziton SHTËPINË E ZOTIT
Ik nga jo besimtarët
Dhe rrebeshet e motit.

Leximi KUR’ ANIT
E frymëzon të dojë njerëzinë
Prapësitë ia ndal një vrull
Të mos harrojë përjetësinë.

NDERIMI I ZOTIT

Nata kur lindi
I dashuri i ZOTIT
Ishte e qetë e kthjellët
Si pika e lotit.

Rrezet e hënës
Shndritnin si fanar
U habit nj[erëza
Kurrë se kishin parë.

Shtëpia mori pamje
Dhe aromë pa përshkrim
- ZOTI E NDEROI-
Me mirësi e amshim.

ZOTI i dhuroi BURIMIN
Që kurrë s' ka mbarim
KUR' ANI FAMËLARTË
Për njerëzimin shpëtim.

BESO PERENDINË

Që të stolisesh
Me para e ar
S’ do jesh rehat
Kurrë në jetë e varr.

Si ke fituar ato
Me djersë e nder
Aty ku ke hyrë
Ke lënë helm e vrer.

Sfidon Zotin
Vdekja thua është larg
Djallin e mallkuar
Ke në trua e barkë.

Lexo KUR’ ANIN
Të besosh PERENDINË
Të lesh rehat vëllezërit
Të gëzojnë lirinë.

LOT GËZIMI SIKUR SHI

Havës i erdhi fryma
Ademit pështyma
Pemës së kuqe mollë
Shejtani tha unë e solla
Hava hëngri e ndeu lezet
Merr tha Ti Adem ç’ pret
Përqafim-dashuri
Lot gëzimi sikur shi
Gufoi barku dalëngadalë
Lumi shkonte valë-valë
U njom toka u rrit bari
Erdhi pranvera erdhi behari
Pastaj lindën dy binjakë
ZOTI krijoi ditë e natë...

NGADHËNJIMI

Ndihmën e ZOTIT
S’ ta jep asnjë prind
Këtë të vërtetë fëmija
Ta di që kur lind.

Këto të vërteta shkruhen
Te LIBRI I ZOTIT
Dhe ngadhënjimi i tyre
Nëpër rrugët e lotit.

Ashtu e mban besimin
Dhe mëshira ndaj njerëzisë
Me dhembje të pa durueshme
Për hir të PERENDISË.

Ai që lexon KUR’ ANIN
I BESON PERENDISË
Siç kujdeset për prindër
I kushtohet edhe fëmijë.

VAJIN NDAL FËMIJA

Shpirtin ma qetëson
Një melodi nga larg
Mjeshtër i madh
Autori në varg.

Shtatë pashë në qiell
Shtatë pashë në tokë
Lulet shpërthejnë
Në luadh e bokë.

Nënës i vjen qumështi
Vajin ndal fëmija
Rrugët mbushen plot
Përmbushen xhamijat.

Ndalen dhembjet
Në trupin e sëmur
I përkulen-EZANIT-
Dhe më s' vinë kurrë.

Të zhduken nuskat
Dredhitë nga jeta
-FEJA ISLAME-
Dhe punë të vërteta.

TRURI

Trupin dhe shpirtin
I përjetëson truri
Me veprat e jetës
Që në shërbim i vuri.

Trupit dhe trurit
Koha u hedh pluhur
Por shpirti e vepra
I ruajnë si gurët në mur.

Flasin për emrin e trupit
Por edhe shpirtbardhësinë
Për veprat madhështore
Që lumturon njerëzinë.

Lexoni KUR' ANIN
Që të gjeni THESARIN
Në kohën më të keqe
Të shijoni beharin.

SHPIRTI

Kurrë mos mendo
Se shpirti ka ngjyrë
siç duken njerëzit
në trup e fytyrë.

Kudo që të ndodhet
Shpirti mburret e krenohet
Kurrë imagjinata e pamjes
Mirësinë s' ia vret.

Epshet njerëzore
I japin shpirtit ngjyrë
Për qëllime të sëmura
Lumturi apo mynxyrë.

Me ZOTIN E KUR' ANIN
Duhet të jeni përherë
Për ngjyrën njerëzore
Shpirti kurrë s' vjell vrer.

LAPSI

Në fletët e KUR’ ANIT
Me laps u mbollën germat
Dijenia e ZOTIT TË BOTRAVE
Për njerëzinë dhuratë e fat.

Për të marrë rrugën e drejtë
I betuar për punë të mbarë
Të pohojë të vërtetën e Kur’ anit
Që nga rreshtat e parë.

Me gjuhë e laps çdo ditë
Mbillni e korrni pasuri
Në rrugën e drejtë të ZOTIT
Do të gjeni o njerëz lumturi.

Krenoheni me KUR’ ANIN E ZOTIT
Burim që mbush oqeane e dete shumë
Prej gëzimit si krijesa me shqisa
Le të shkojnë lotët rrëke lumë.

URATAT

Atë që e ke në kokë
Duhej ta mbjellësh në letër
Pasi për gjatësinë e jetës
Përgjegjës është dikush tjetër.

Pastaj ta hapësh rrugën
Në katër anë të botës
Dikush do të thotë
MJAFTË AHENGUT TË GOTËS.

Do të jesh me ta
Natë ditë
Fjalët e bukura në varg
Fëmijës i shtojnë rritë.

Uratat e tyre
I pranon Perëndia
Si prej Ajeteve KUR' ANORE
Që përherë rrjedh dijenia.

DHURATA E PERËNDISË

S’ ka njeri të mençur
Që bëhet rob i pasurisë
Veçanërisht kur ndërmjetëson
Edhe dora e tradhtisë.

Këtë ofertë e pati
Edhe i dashuri i PERËDISË
Por ai i lumtur zgjodhi
Rrugën e DREJTËSISË.

Qëllimin e arriti
Me djersë e mund plot
Sukseset i radhiteshin
Siç radhiten edhe sot.

PASURI MË TË MADHE
Se KURA’ ANI s’ ka në botë
-DHURATA E PERËNDISË-
Që shndrit kah mot...

GURI I PUSHIMIT

Në skaj të fshatit
Te GURI I PUSHIMIT
U ul gruaja fisnike
Ti kundërvihet pikëllimit.

Plaku i ndershëm
Me shumë mençuri
Të ma ruash tha nipçen
Do të shpërblej me flori.

Mos u mërzit tha fisnikja
Jam një nënë me përvojë
KY YLL DRITE do të ketë
Zemra e shpirti ç' ti dojë.

Halimeja ishte e bindur
Në ZOTIN E VËRTETË
Prandaj i erdhën ato të mira
Që si kishte pasur në jetë.

Prandaj Ju o njerëz
Besoni PERËNDISË
KUR' ANIT DHE PROFETIT
Burime të përjetësisë.

ÇLIRIM NGA MISTERI

Çdo fjalë e shkruar
Është për ty o njeri
Të hulumtosh tokë e qiell
Për jetë e pavdekshmëri.

Fjalët e shkruara
I përjeton me zemër
Dhe për KRIJUESIN ZOT
S’ thua tjetër emër.

Bindesh me shpirt e zemër
Me plot devotshmëri
Çlirohesh nga misteri
Në trup ndjen freski.

Këto fjalë të shkruara
Janë radhitur në KUR’ AN
Pasuria më shtrenjtë
Që Muslimanët e kanë.

FRYMËZIMI

Truri, shpirti e zemra
Pajtohen e bëhen një
Pastaj i thonë syrit
Ndalu pak, këtu rri.

Gjersa kënaqen
Me ata bukuri
Truri thotë: ç' pret
-SHKRUAJ O NJERI-.

Ajo që mbillet
Përherë ngel në letër
Ty të jep emër
Por kënaq edhe tjetër.

Siç jeni kënaqur
Dhe aftësuar prej DITURISË
Nga KUR' ANI famë lartë
-FRYMËZIM VËRTETË I PERËNDISË-.

DRITA

Si hëna që shndrit me rreze
Zemra të shndris me Dituri
Edhe vet ZOTI të krenohet
Me krijesën që i thonë njeri.

DRITA tregon rrugën
Ti japish drejtim Veprimtarisë
Të bësh vepra të mëdha
Për të mirën e njerëzisë.

Në tërë botërat
Ka vetëm një të vërtetë
-VETËM ZOTI ËSHTË NJË-
Dhe s’ ka asnjë të metë.

Si burim drite
-VETËM KUR’ ANI SHNDRIT-
Krijesës që i thonë –NJERI
Në çdo vend i shton rritë.

DITURIA

Mos shiko vendin dhe gjuhën
Për të marrë DITURINË
Pasi i ditur je i dobishëm
Për vetveten dhe shoqërinë.

I frenon epshet
Dhe i ik çdo gabimi
Beson ZOTIN e vërtetë
Asnjë lloj adhurimi.

Çelësat e jetërave
I ka PERËNDIA
Por dyert e pengesave
I hap dituria.

Kur ta lexoni KUR' ANI
Do të bindeni vetë
DITURIA prej AJETEVE
Është ÇELËS i vërtetë.

MREKULLIA

Njeriu i mençur
Bënë edhe mrekulli
Besimin ia ka falur ZOTIT
ZOTI i ka falur dituri.

I forti s’ beson aspak
Pasi ka mjaftë pasuri
Ashtu si Faraoni
Me plot kokëfortësi.

Që s’ donte të dëgjojë
Për ekzistimin e ZOTIT
S’u besonte mrekullive
As rrebesheve të motit.

KUR’ ANI na tregon
Për shumë mrekulli
Leximi me vëmendje
E bind çdo njeri.

RREZE MIRËSIE

Në mëngjes kur takohet
Syri me rrezet e diellit
Mendo për të mirat e ZOTIT
Në Tokë dhe lartësitë e qiellit.

Mendo për të mirën
Të keqen sfido përherë
Atë që s' është e jotja
Mos e lakmo-mos e merr.

Për të gjithë veprat
Kujdeset vetëm ZOTI
Dënim më i rëndë është
Aty ku mbillet loti.

Na dërgoi KUR' ANIN
-ZOTI I GJITHËSISË-
Të jemi të devotshëm
SI RREZE TË MIRËSISË.

KOHA

Koha është si lumë
Që rrjedhë përherë
Si në dimër –
Ashtu në verë.

Koha s’ të pret
Pasi s’ ka mëshirë
I regjistron veprat
Të keqe dhe të mirë.

Besimtarët e ZOTIT
Kanë bërë edhe çudira
Koha i ka vulosur
Si vepra të mira.

Kur’ ani ndër to
Është PIADESTALI
Që ZOTI njerëzisë
Me dëshirë ia fali.

LUFTA

Besimtari i mirë
Kurrë luftë s’ të shpall
Por nëse të shpallet
Duhet ti bësh ballë.

Armiku ka qëllim
Të të shkatërrojë pasurinë
Të të vrasi popullin
Dhe të të vendojë robërinë.

Këtë na e mëson
Biografia mbi PROFETIN
Dhe pengesat e popullit
Që të shprehin vullnetin.

Të mbrosh ATDHEUN
Është PARIM KUR’ ANOR
Me ndihmën e ZOTIT
Dhe namazin ditor.

JA-SINI

ZOTI njeriut i dha zemër
Siç ka JA-SININ KUR’ ANI
Të dallojë mrekullitë nga vinë
Me rrënjë të thella tabani.

Për ditën e gjykimit
Të mendojë në këtë botë
Djallit të mos i bëhet shok
Pasi vdes, pendimi është kot.

Kokën mos e mbani lartë
ZOTI për ne ka shpërblim
-DITËN E GJYKIMIT-
Ai të hidhe në përqafim.

Si bebëza e syrit njerëzor
Për KUR’ ANIN është JA-SINI
Prandaj Ju o njerëz
Mendoni nga shkoni e si vini.

VEPRA E DËSHMI

O njeri-bindu
Në vepra e dëshmi
Kur të kënaqet zemra
E shpirti ka kufi.

Pastaj mendo me kokë
Krejt aj nga vjen
-DËSHMIA E ZOTIT-
Kurrë s' është rrenë.

Prandaj në çdo kohë
Përjeto veprën me zemër
Pse ke tipare njeriu
Dhe mbanë atë emër.

ZOTI na ka dërguar
Libra e profetë të tjerë
Por Muhamedi dhe KUR' ANI
Janë me tjetër vlerë.

BINDU O NJERI

Si adhuron statujat
Që ke gdhendur vetë
Dhe ndihmë o njeri
Ti prej asaj pret.

Aty ku e vendon
Dhe s' luan asnjëherë
E ti o njeri pret
Dimrin të ta bëjë verë.

Pse s' bindesh o njeri
ZOTIT TË VËRTETË
AI ËSHTË KUDO
Dhe e bëri këtë jetë.

Lexo ç' na porosit
ZOTI PAS KUR' ANIT
Kënaqu me mrekullitë
E fesë së Islamit.

JETA SHPIRTËRORE

Qetësia kthjellon trurin
Të kthen në jetën shpirtërore
Të pastron të pamurit
Dhe mendon për jetën njerëzore.

Bëhesh i kompletuar
Beson në atë që të ka krijuar
Të ka dhënë shpirt e shqisa
Prandaj tjetër ‘ duhej pranuar.

Nga mendja largon punët e liga
Ashtu e ruan nderin e shtëpisë
Të respekton rrethi familjar
Kurrë s’ gabon ndaj PERËNDISË.

Engjëjt të shtynë të lexosh
Librin e Shenjtë KUR’ ANIN
Që të lidhe fortë e ngushtë
Me VATANIN dhe IMANIN.

LIBRI I JETËS

Emrat që mbani
I keni kot pa besim
Prej ZOTIT të motrave
Shpirtin e pret gjykim.

Parajsa fitohet
Me besim në ZOT
Por edhe ferri plot zjarr
Me besimin e kot.

Jeta e juaj kalon
Si uji në lumë e det
Veprat e mira e të këqija
Ajo kurrë si pret.

Engjëlli regjistron
Në LIBRIN E JETËS
Prandaj madhëroni ZOTIN
Për KUR' ANIN E TË VËRTETËS.

GURI I ZI

Mos bëni përçarje
Për famë e pasuri
Lexoni çfarë ndodhi
Për GURIN E ZI.

Plaku i mençur
Dha një propozim
Kurse Muhamedi a.s.
Përçarjen e mundi me besim.

Durimi dhe këshillat
Për njeriun janë obligim
Që të zbusin epshet
Dhe të gjejnë shpëtim.

ZOTI na dërgoi KUR' ANIN
Rrugën e drejtë për jetë
Libri më i përsosur
Çdo fjalë shkencë e vërtetë.

BESIMI I DREJTË

Trupin e shpirtin
I bashkon DIJENIA
Dhe BESIMI I DREJTË
Ç’ Është PERËNDIA.

Emri njeri
Shndrit si yll
Si burimet e jetës
Që ndodhen në pyll.

ZOTI I PLOTFUQISHËM
NDODHET Çdo kund
Bë mirë sa je gjallë
Pasi vdes krejt merr fund.

Burimi i dijenisë
Është KUR’ ANI FAMËLARTË
Lexoni me kujdes
E me zemër të zjarrtë.

RRESHTIMI

Atje ku flitet
Dëgjo dhe hesht
Ti kuptosh fjalët
Siç vinë rresht.

Ashtu si besimtarët
Që rreshtohen në xhami
Të kryejnë obligimet
Me plotë liri e qetësi.

Siç u rreshtuan Profetët
Me urdhër të PERËNDISË
Të mençur e të ditur
Shpëtimtar të njerëzisë.

Si rreshtimi AJETEVE në KUR' AN
Dhe në qiell planetët e renditura
Të përhershëm në rrugët e vet
Prandaj s' ka të pa pritura.

SHIU

Shi binte dje
Bie edhe sot
Do të bie edhe nesër
Pa të s’ mundemi dot.

Është mrekulli e ZOTIT
Që tokës ti japi jetë
Besoni dhe bindeni
Ajo është e vërtetë.

Shiu mbush lumenjtë
Det dhe oqean
Burime të pa shtershim
Në botë, dhe çdo anë.

KUR’ ANI FAMËLARTË
Shkruan me përpikëri
Që pikat e ujit në tokë
S’ lejon vdekshmëri.

BETIMI

Njeriu në agim
Duhet ti betohet ZOTIT
Për punë të mbara
Gjatë ditëve të motit.

Ai që ka mend e shpirt
Dhe kupton ç' është dënimi
Zgjedh rrugën e ZOTIT
Pasi ajo është mbarsmëri.

Ashtu i ndal prapësitë
Kurrë si afrohet djalli
E kënaq pasuria shpirtërore
Jo paraja, toka e malli.

ZOTI do ta shpërblejë
Me PARAJSËN në amshim
Siç shkruan në KUR' AN
Për njerëzit shpëtim.

PËRCAKTIMI

Përcaktohu me zemër
Ti o njeri
Ose për besim
Ose për prapësi.

Zemra e pastër
Dhe sinqeriteti në fjalë
Shkallmojnë padrejtësitë
Dhe shkëmbinjtë në mal.

Mos i beso djallit
Të shtyn në zili
Gjëja më e keqe
Që është për njeri.

Merr rrugën e ZOTIT
Besimtarët që kanë
T'u iki prapësive
Të trasuar me KUR' AN.

ORIENTIMI

Namazi do të falet
Sa të ekzistojë jeta
Me ORIENTIM të ndryshuar
Përherë nga MEKA.

Prandaj duhej vizituar
Atë vend plotë mrekulli
Ku u ndërtua shtëpia e ZOTIT
Që njerëzit i thonë XHAMI.

Atëherë s' ka dallim
Në pamje e pasuri
Të krejt përpara ZOTIT
Janë krijesa- NJERI.

Atje në afërsi ZOTI
Shpalli KUR' ANIN
Orientimin njerëzor
Për fenë e Vatanin.

AGJËRIMI

Si shtyllë kryesore
Është edhe agjërimi
ZOTI s' ka nevojë
Por dëshmohet besimi.

Pastrohet trupi
Këndellet shëndeti
Me plotë besimtarë
Përmbushet XHEHENETI.

Bisedohet për festën
Ditën Bajramit
Urime të përzemërta
Besimtarë të Islamit.

Lexohet KUR' ANI
Prej ZOTIT amanet
Të bindur për në amshim
Këtu askush s' ka mbet.

VIZITA

Vizito të sëmurit
Dhe prindërit në largësi
Rikthe dashurinë
Kur ishe fëmijë.

Një përqafim i ëmbël
Dhe bisedat e mira
I afrojnë zemrat
Dhe rrënjoset mëshira.

Ço pak kokën lart
Prej famës e pasurisë
Por kurrë mos u bë
Armik i PERËNDISË.

Për të zhdukur egërsinë
Lexo ç' thuhet në KUR' AN
-POROSITË E ZOTIT-
PAS Muhamedit alejselam.

VIZITAT E SHENJTA

Vizita në Mekë e Medine
Pastaj edhe shpellën HIRA
Ku lindi KUR' ANI
Që na solli të mira.

Do të jesh i nderuar
Dhe i lumtur në jetë
Kryen një nga kushtet
Si besimtar i vërtetë.

Do ta zbusësh shpirtin
Me djallin s' ke punë
Mbi shpirtrat e ZOTIT
Më s' përdor dhunë.

Ditën fillo e mbaro
Me AJETE KUR' ANORE
Me shpirt e dinjitet
Të zemrës njerëzore.

KURBANI

Nëse flijohet KURBANI
Për hir të ZOTIT
Ato rrëke gjaku
Gjallërojnë stinët e motit.

Atje në atë jetë
Që i thonë SMSHIM
Ai lumë i kulluar
Të jep jetë e shërim.

SHPIRTI I KURBANIT
Të del përpara si fëmijë
Të pres thotë prej kurrë
Me plotë dashuri.

KURBANI të flijohet
Me RREGULLA KUR' ANORE
Të bashkohen shpirtrat
Dhe zemrat vëllazërore.

HAXHI

Prej zërit të njeriut
U rrafshuan edhe malet
Me zemër e shpirt ZOTIT
Çdo njeri i lutet e falet.

Të pastër në shpirt e zemër
Siç duken në IHRAM
Të betohen me kurbanin përpara
Në devotshmëri e kundër haram.

Të vendosur për besim të drejtë
Pasi ZOTI ia zërit atë fuqi
Që malet të ulin lartësitë
-URDHËRO O ZOT-të thotë çdo njeri.

KUR' ANI shkruan për HAXHIN
Ku njerëzit janë të barabartë
Të betuar në ZOTIN botërave
Me shpirt e me zemër të zjarrtë.

GËNJESHTARI

Ti o njeri
Që gënjen tërë jetën
Edhe pse s’ donë në varr
Do të tregosh të vërtetën.

Varri do të jetë varr
I ftohtë e i vërtetë
Pasi veç prapësi
Paske bërë në jetë.

Afër do shikosh në varr
Plotë lule e mrekulli
Do të duash të marrish
Por atje s’ ka dredhi.

Pse s’ besoje ZOTIN
Tash krejt është vonë
As lexoje KUR’ ANIN
AJETET E ZOTIT ç’ thonë.

PESHORJA

Atë që e le mangët
Përherë në peshore
Në librin e mëkateve
Engjëjt e shënojnë prore.

Ta japin peshoren
Që të marrin hakun
Jo blerësve të ngratë
T’ ua pishë gjakun.

Atë e bënë me kënaqësi
Se si frikohesh dënimit
Se respekton ZOTIN
As DITËN E GJYKIMIT.

S’ ke lexuar KUR’ ANIN
Ç’ shkruan për peshimin
As çka thotë ZOTI
Për dëmin e krimin.

RINGJALLJA

Ditën e ringjalljes
Do të peshohet pasuria
Por mos mendoni në pallate
Ku shtypej njerëzia.

Çdo gjë del në shesh
Aty s’ ka fshehtësi
PESHORJA E AMSHIMIT
Do të mati DREJTËSI.

Toka me male do të dridhet
Pastaj do të kapi një errësirë
Njerëzit do të ndahen në grupe
Në mëkatarë e të mirë.

Djalli mëkatarët
Do ti përqeshi përkarshi
Do ti pyeti për pushtet
Por edhe pasur.

Ata që kanë nderuar ZOTIN
Dhe KUR’ ANIN si rrugë drejtim
Do të kenë bukuritë e PARAJSËS
Të përhershëm si vendbanim.

DERA E XHENNETIT

Me mirësi hapen rrugët
Në rreth të ngrihet vlera
ZOTI të shpërblen
Për në Xhehennet të hapet dera.

Engjëjt janë gëzuar
Që të ndjekin në jetë
Del përpara DREJTËSISË
Çdo fjalë të vërtetë.

Shejtanët pëlcasin
Kurrë si ke bërë shokë
Ke menduar për amshimin
Por edhe këtë botë.

Rrugëve të KUR' ANIT
Kurrë s' u mbyllet dera
ZOTI ju shpërblen
Kurrë s' u bie vlera.

LEXIMI

Aty ku lexohet
Duhet të ketë qetësi
Truri i çlodhur
Të kapi dijeni.

Edhe trupi i shëndoshë
Mbahet me pastrim
Aktivitete e punë
Por edhe mjaftë mësim.

Dijenia të bashkohet
Me shpirt e mish
Që pengesat e djallit
Të jenë disa fish.

Ditën e gjykimit
Do të ndihemi me fletë
Duke lexuar KUR' ANIN
Do të bindeni vet.

RREBESHI

Ai që s’ beson ZOTIN
Asgjë s’ arrin
ZOTI pak hidhërohet
Por ka durim.

Jetën s’ ia merr
Ai njëherë ia jep
Le të jetë e gjatë
Por ka me vdekë.

DITËN E GJYKIMIT
Krejt del në shesh
Vetë do të pendohet
Nga ai rrebesh.

Prandaj besoni ZOTIN
Lexoni KUR’ ANIN FAMËLART
Të mos bëni gabime
Ajete shkruajnë qartë.

HIPOKRITËT

Keni ardhur në botë
Si njerëz të pa fytyrë
Kënaqeni kur bindeni
Se keni mbjellë mynxyrë.

Përdorni aftësi e rena
Që të formoni një rreth
Pastaj ua ktheni shpinën
S’ doni hisedarë në ledh.

Dikur do paguani
Me pasuri e kokë
Pasi edhe ZOTI i urren
Ata njerëz në tokë.

Pse keni atë zemër
Të bëni krime pa ndal
Lexoni ç’ thotë KUR’ ANI
ZOTI shpirtrat i falë.

DJALLI I MALLKUAR

Epshet i frenojnë
Shpirti e ndjenjat
Pasi qëllimet e tyre
Mirë i pesho e i mat.

Shpirti e do të vërtetën
Por epshi shpesh bënë largim
Pasi bashkohet me djallin
Që shpirti të pësojë dënim.

Të thuash se s' ZOT
Ka qëllim i mallkuari djall
Prandaj në trupin e njeriut
Epshet zjarr e flakë i kall.

Shpirti e ndjenjat
Janë të lidhura me PERËNDINË
Dhe AJETET KUR' ANORE
Për të shpëtuar njerëzinë.

DJALLI

Edhe pse i pa dukshëm
I bënë shumë dëm njerëzisë
Me marifetllëqe e ndyrësira
I largon nga rruga e PERËNDISË.

Edhe kurrë s' pendohet
Për atë rrugë që trason
Kundër ZOTIT e njerëzisë
Edhe pse të mira s' fiton.

S' paska as shpirt as zemër
Që të thuash njëherë ndal
Dikur do të japish llogari
Edhe ty ZOTI të ka fal.

Pse i ngjitesh njeriut
Dhe i trason rrugë mashtruese
Të lejë rrugën e drejtë KUR' ANORE
Pasi vetëm ajo rrugë është shpëtuese.

PËRMBAJTJA

1. Kur' ani..... 6
2. Përjetimet (Muhamedit a.s.)..... 7
3. Profetët..... 8
4. Engjëjt..... 9
5. Besimtari..... 10
6. Nderimi i Zotit..... 11
7. Beso Perëndinë..... 12
8. Lot gëzimi sikur sh.....13
9. Ngadhënjimi.....14
10. Vajin ndal fëmija.....15
11. Truri.....16
12. Shpirti.....17
13. Lapsi..... 18
14. Uratat.....19
15. Dhurata e Perëndisë..... 20
16. Guri i pushimit.....21
17. Çlirim nga misteri..... 22
18. Frymëzimi.....23
19. Drita..... 24
20. Dituria.....25
21. Mrekullia.....26
22. Rreze mirësie.....27
23. Koha.....28
24. Lufta..... 29
25. Ja-sini.....30
26. Vepra e dëshmi..... 31
27. Bindu o njeri.....32
28. Jeta shpirtërore..... 33
29. Libri i jetës.....34
30. Guri i Zi.....35
31. Besimi i drejtë.....36
32. Rreshtimi.....37
33. Shiu.....38
34. Betimi.....39
35. Përcaktimi.....40
36. Orientimi.....41
37. Agjërimi.....42
38. Vizita.....43

39. Vizitat e shenjta.....44
40. Kurbani.....45
41. Haxhi.....46
42. Gënjeshtari.....47
43. Peshorja.....48
44. Ringjallja.....49
45. Dera e Xhennetit.....50
46. Leximi.....51
47. Rrebeshi.....52
48. Hipokritët.....53
49. Djalli mallkuar.....54
50. Djalli 55
51.

S’ lejohet ribotimi dhe shpërndarja e librit pa autorizimin e autorit.

-CIP-Katalogizimi në publikim
Biblioteka Kombëtare dhe Univerzitare
“ Shën klient Ohridski”, Shkup

821. 18 (497.7)-1

RRAHMANI, Begzat
Rreze mirësie : poezi / Begzat Rrahmani.- Kërçovë

Bibliografia kronologjike me përmbajtje fetare të autorit Begzat Rrahmani të botuara nëpër gazeta dhe revista të shtypit periodik / për bibliografinë u kujdes dhe e mblodhi Gëzime Baftiri : f. 57-60

ISBN 9989-9669-6-6

COBIS-ID 51855114